



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 2212/13 prot.

Tiranë më 16.10.2023

VENDIM

Nr. 107/11, datë 16.10.2023

“MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 107, DATË 04.04.2023 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE PËRSHKRIMET E PUNËSTË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË ”

Në zbatim të Ligjit nr. 98 datë 06.10.2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 27, 28 dhe 38, që parashikojnë përkatësisht funksionimin dhe kompetencat e Këshillit të Gjykatës, Vendim nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, Vendim nr. 147, datë 29.03.2023 “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”, Vendim nr. 148, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisve të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me propozim të Zv/Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

KONSTATON

Duke qenë se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm është e ndarë në dy godina, (Dhoma Civile dhe Dhoma Penale) operohet me dy sportele protokolli dhe për këtë arsye ka lindur nevoja që, pa ndryshuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Gjykatës, të ndryshohet struktura duke vendosur dy specialistë protokolli. Për ta bërë të mundur këtë gjë do të shkërtohet një pozicion sekretare gjyqësore dhe do të shtohet si specialist protokolli, që do të thotë nga 113 sekretaret gjyqësore që janë aktualisht në strukturën e miratuar me vendimin nr. 107, datë 04.04.2023, të Këshillit të Gjykatës do të jenë 112 sekretare gjyqësore.

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 1 që ka të bëjë me miratimin e strukturës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas vendimit nr. 148, datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur.

2. Ndryshimin e pikës 2 që ka të bëjë me miratimin e organigramës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur.
3. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Këshillit të Lartë Gjyqësor menjëherë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT
Flamur KAPLLANI

ANËTARE
Majlinda DOGGA



ANËTAR
Donald XHELILI

DETAJIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR GJYKATËN TIRANË

N r	Funksioni	Numri Faktik	Numri Organi k	Vendet Vakant e	Kategorizi mi pagës
			272		
1	KRYETAR		1	1	
2	ZV/KRYETAR	1	1	0	
3	GJYQTARË	42	80		
4	KANCELAR	1	1	0	I-4
5	K/SEKRETAR	2	2	0	III-1
6	SEKRETARE GJYQËSORE	105	112	8	IV- 1
	DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR				
1	DREJTOR DREJTORIE	1	1	0	II-1
2	SPECIALIST BUXHETI	1	2	1	IV- 1
3	SPECIALIST FINANCE	2	2	0	IV- 1
4	MAGAZINIER	2	2	0	
	SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE , SHERBIMEVE MBËSHTETËSE DHE				
1	SHEF SEKTORI	1	1	0	III-1
2	SPECIALISTË BURIMEVE NJERËZORE	1	1	0	IV- 1
3	SPECIALIST SHËRBIMEVE MBËSHTETËS		1	1	IV- 1
4	SPECIALIST PROKURIMESH	2	2	0	IV- 1
5	SANITAR	7	7	0	
6	SHOFER	3	3	0	
7	MIRËMBAJTËS	2	2	0	

8	PUNONJËS SIGURIE	9	10	1	
9	NËPUNËS GJYQËSOR	21	24	3	
	SEKTORI IT, STATISTIKE DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN DHE MEDIAN				
1	SHEF SEKTORI	1	1	0	III-1
2	SPECIALIST IT	3	3	0	IV- 1
3	SPECIALIST STATISTIKE	1	1	0	IV- 1
4	SPECIALIST MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE MEDIAN	1	1	0	IV- 1
	SEKTORI I KORDINIMIT TË ZYRAVE TË SHËRBIMIT DHE PROTOKOLL / ARKIVE				
1	SHEF SEKTORI	1	1	0	III-1
2	SPECIALIST PROTOKOLLI		2	1	IV- 1
3	SPECIALIST ARKIVE	7	7	0	IV- 1
4	ZYRA SHËRBIMIT KRUJË	2	3	1	IV- 1
	TOTALI	176	192	16	

Aneksi 2

Organigrama e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

272



